

Aneksi A

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Kërkues-shpëtues/shofer	4031, KM	Mengel, Elbasan	3-mujore	po	jo	23.11.2023	07.12.2023

SHPALLJE VENDI I LIRË PUNE

Formulari nr. 1

1. Pozicioni i punës: Kërkues-shpëtues/shofer
2. Kodi i pozicionit: G-001, C, 03, 003, LT 2150
3. Reparti/Institucioni: RU 4030, Komanda Mbështetëse
4. Vendi: Mengël, Elbasan
5. Paga: Sipas VKM-së, nr.326, datë 31.05.2023
6. Lloji i kontratës së punës: Për një kohëzgjatje të përcaktuar
7. Data e fillimit të aplikimit: 23.11.2023
8. Data e mbylljes së aplikimit: 07.12.2023
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Njesisë së Personelit të Strukturës që është e interesuar për rekrutimin, brenda afatit të caktuara, në zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën (adresa postare e repartit/strukturës përkatëse): <i>Degës së Personelit</i> <i>Komandës Mbështetëse</i> <i>Vaqarr</i> <i>Tiranë</i>
10. Dokumentet e aplikimit: Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none">▪ kërkesën;▪ formularin e aplikimit;▪ fotokopje të kartës së identitetit;▪ diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal;▪ fotokopje të patentës;▪ dëshmi profesioni nëse ka;▪ certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja▪ raport mjekësor;▪ fotografi me përmasa 4x6, 2 copë; 9x12, 2 copë.▪ dëshmi penaliteti;▪ vërtetim nga gjykata;▪ vërtetim nga prokuroria;▪ librezë pune;▪ jetëshkrimin (CV).▪ formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën

elektronike ëëë. mod.gov.al. ([linku: Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit](#))

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 25 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: N/C
- b. Arsimi : I Mesëm
- c. Kualifikimi: Të jetë i aftë në realizimin e detyrave të lidhura me mjetet ushtarake.
- d. Eksperienca në Punë: Mbi 3 vjet

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.
Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Njësia e personelit të strukturës që është e interesuar për rekrutimin, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e personelit verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcaktonë kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotëojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.